



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 32-3/1 Prot.

Roskovec, më 30.04.2026

Procesverbal Nr.4

-I mbajtur sot, datë 30.04.2026, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Mars 2026.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Mars 2026.
5. Për anëtarësimin e Bashkisë Roskovec në Shoqatën e Qyteteve dhe Rajoneve për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Burimeve (Association of Cities and Regions for Sustainable Resource Management / ACR+).
6. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026.
7. Për një shtesë në Paketën Fiskale për vitin 2026.
8. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰⁹

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, H.Hajdini, E.Toska, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, P.Toro, V.Çepele, F.Feleqi.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, Zh.Metushi, N.Zeka, J.Begaj, A.Hoxha, A.Pelo, S.Bibo Qamili.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Financës O.Goga, Dr.Ardhurave Vendore S.Çepele, Dr.Urbanistikës E.Hoxha, P/Zbatimit të Investimeve A.Hoxha, Sp/Integritimit European U.Blido, P/Shërbimit Social E.Kola.

Me plotësimin e kuoromit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 14 këshilltarë. Kryetari – mirdita të nderuar këshilltar, të nderuar përfaqësues të administratës, faleminderit që jeni bërë pjesë e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Roskovec për muajin Prill 2026. Ashtu siç jeni njohur me njoftimin e datës 24.04.2026 dhe me rendin e ditës përkatës, do doja tju

kujtoj vetëm se për pikën 7 të rendit të ditës “Për një shtesë në Paketën Fiskale për vitin 2026” keni një relacion të përditësuar që ua kemi shpërndarë sot në fillimin e kësaj mbledhje. Nuk kemi asnjë ndryshim nga rendi i ditës i shpërndarë tek ju në datën 24, në qoftë se askush nga ju për procedurë nuk kërkon fjalën sa i takon rendit të ditës, ju ftoj që të votojmë rendin e ditës, me të cilin jeni njohur paraprakisht.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës si më sipër dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro të këshilltarëve të pranishëm miratohet rendi i ditës.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Mars 2026.

Kryetari- vazhdojmë me një informacion të shkurtër mbi vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Mars 2026. Ftoj Sekretaren znj.Arlinda që të bëjë një relacion shkurtimisht në lidhje me vendimet e marra në mbledhjen e muajit Mars. Këshilltarët shprehen se e kanë informacionin dhe e kanë lexuar, dhe që të vazhdojmë me pikat e tjera. Kryetari- gjithsesi për procedurë unë duhet që të respektojë rendin e ditës, në qoftë se nuk është e nevojshme dhe nuk e shikoni të arsyeshme, atëherë kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- ju jeni njohur të gjithë me procesverbalin, dikush ka diçka në lidhje me procesverbalin e mbajtur nga mbledhja e kaluar? Nuk ka. Kryetari- atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të miratojmë procesverbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak. Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Mars 2025.

Kryetari- tju pyes, vazhdojmë me të njëjtin parim që kemi bërë dhe në mbledhjet e kaluara apo jo? Këshilltarët shprehen po. Kryetari- ok, për pyetje dhe për diskutime nuk e kërkon askush..P/Shërbimit Social Enkeleda- më fal pak Kryetar, doja të bëja një saktësim. Tek Njësia Administrative Kurjan është bërë një lapsus, vlera me numra është e saktë dhe kur është shkruar me fjalë është bërë njëqind mijë e shtatëdhjetë e gjashtë, ndërkohë vlera reale është dhjetë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë. Fredi- kisha një pyetje, sipas një vendimi të Këshillit dhe miratimit nga Kryetarja e Bashkisë, e kemi lënë që lista e personave që marrin ndihmë ekonomike të jetë e afishuar në qendrat administrative, ndodh akoma apo është harruar? Enkeleda- unë po tregohem reale, janë tek dy muaj që listat nuk janë afishuar por do të vazhdojë..Fred- jo pa qëllim e thashë, mos të ndodhë më..Enkeleda- tani unë po e flas para jush këtu dhe duke filluar që nga listat e muajit Prill, porsa të na vij vendimi sepse neve na ka dalë vendimi në sistem por deri në momentin që neve na vjen vendimi me shkresë, ne nuk nxjerrim dot listë. Në moment që të na vij vendimi me

shkresë, listat do të afishohen në çdo njësi përkatëse. Kryetari- mirë faleminderit, dikush tjetër kërkonte fjalën? Po fjala është për z.Elmaz. Elmazi- sa i përketë materialit, e tha dhe vet ajo që bëri atë korigjimin. Përsa u përketë listave të këtyre personave, unë si anëtar i Këshillit nuk isha i mendimit që ne ti afishojmë nëpër qendrat e njësisve, le që perëndia atyre u ka dhënë një diçka që smunden, por ska pse të jenë atje të afishuara. Kushdo nga këshilltarët nuk e pengon njeri, le të paraqitet tek zyra përkatëse dhe të marr emrat nëse dyshon..Kryetari- faleminderit z.Elmaz, por kjo është diçka që ne e kemi diskutuar disa herë në këtë Këshill dhe është jashtë rendit të ditës dhe nuk besoj se meriton që ta diskutojmë akoma. Elmazi- po nuk është e drejtë..Kryetari- në lidhje me projekt-vendimin? Fredi- nuk është turp, më fal por ai që ka turp të marri ndihmë ekonomike, të heqi dorë nga ndihma ekonomike. Ne këtë vendim e kemi marr, ti rikthehemi këtyre budallëqeve është turp. Kryetari- nuk po kthehemi dhe po ju ftoj të nderuar këshilltar nëse keni ndonjë pyetje apo diskutim në lidhje me projekt-vendimin që jemi duke diskutuar? Nuk kemi, atëherë në mungesë të pyetjeve dhe diskutimeve në lidhje me projekt-vendimin, unë ju ftoj të nderuar këshilltar të votojme projekt-vendimin “Për dhënie e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Mars 2025”, me saktësimin nga ky projekt-vendim pikërisht për Njësinë Kurjan, në bazë të relatimit që specialistja bëri këtu përpara këtij Këshilli. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin me saktësimin si më sipër dhe miratohet unanimitet me 14 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro miratohet ky projekt-vendim, faleminderit për votimin. Enkeleda-faleminderit. Kryetari- faleminderit edhe juve.

5.Për anëtarësimin e Bashkisë Roskovec në Shoqatën e Qyteteve dhe Rajoneve për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Burimeve (Association of Cities and Regions for Sustainable Resource Management / ACR+).

Kryetari- për këtë projekt-vendim ftoj specialisten përkatëse që të na bëj një raport të përmbledhur. Sp/Integritet Europian Ulpiana- përshëndetje të nderuar këshilltar, dhe unë paraprakisht doja të saktësoja që referuar kostos për antarësimin duke përfshirë dhe komisionet bankare, duhet të ketë një saktësim që është shifra 78 mijë ajo që është dëshifruar në kllapa, shtatëdhjetë e tetë mijë duhet të jetë pjesa e perifrazimit në kllapa e shkruar. Projekt-vendimi që unë ju paraqes për miratim ka të bëjë me antarësimin e Bashkisë Roskovec në shoqatën e qyteteve dhe rajoneve, për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ose ndryshe ACR (Association of Cities and Regions for Sustainable Resource Management) që është emri në anglisht i shoqatës. Atëherë shoqata e qyteteve dhe rajoneve për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, është një rrjet ndërkombëtar qytetesh dhe rajonesh, që ndajnë një qëllim të përbashkët, promovimin e praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe është themeluar për të inkurajuar inovacionin, transferimin e njohurive dhe bashkëpunimin të lëvizjes drejt një ekonomie rrethore. Leksi- e kemi këtu materialin, një pyetje? Kryetari- a mund të mbarojë raportin dhe të bësh pyetjen, sepse mund të ketë të interesuar që duan ta dëgjojnë. Gjithsesi bëjeni pyetjen meqënëse filluat..Leksi- vetëm shkurt për pjesën që çfarë përfitimesh kemi, të koncentruar se për të lexuar këtu e kemi..Ulpiana- duke u bërë anëtare Bashkia e Roskovecit si pjesë përfaqësuese e kësaj shoqate, normalisht ne kemi mundësi të arrijmë tek pjesa e bashkëpunimit, duke qënë se pjesë e kësaj shoqate janë edhe qytete ose bashki të tjera europiane, mund të kemi shkëmbime të praktikave të mira, dhe kjo shoqatë operon kryesisht duke qënë se ka dhe për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve në aspektin e mjedisit, duke u fokusuar gjithmonë e më shumë drejt ekonomisë qarkulluese, për

menaxhimin e mbetjeve që gjithashtu është një nga pikat zhvillimore të Bashkisë tonë. Kjo është një përmbledhje referuar pse Bashkia do të jetë anëtare e kësaj shoqate. Kryetari- po, fjala është për znj.Dhurata. Dhurata- faleminderit Kryetar. Tani vajza sapo e sqaroi qartë aty, ndërkohë e kemi dhe të shkruar këtu. Qëllimi kryesor i kësaj shoqate ACR thotë aty që është promovimi i ekonomisë qarkulluese, pra riciklim, ripërdorim dhe reduktim mbetjesh. Tani shoh që mbetjet janë të gjitha të futura nëpër ata kazanët atje, herë i marrin e herë si marrin punëtorët e Bashkisë sepse unë e kam bërë vërejtje herë pas here në çdo mbledhje, e para. Dhe e dyta, riciklim aty, këtu tani përveç kartonit që është mbledhur, tjetër gjë unë skam parë sepse normalisht po të ishte bërë do ishin ndarë ata kazanet siç e kanë të tëra vendet e botës, siç e kanë ato qytetet që do angazhohen në këtë shoqatë. Dhe së treti thotë menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të zonës tonë, kryesisht qytetit tonë. Cilat janë këto burime natyrore që ne jetojmë, që do menaxhohen kaq bukur nga kjo shoqatë? Mbrojtja e mjedisit dhe klimës thotë këtu, si e mbron kjo shoqatë që do bashkohemi ne, do bëhemi pjesë e saj ku ka një kuotë të caktuar 780 mijë lekë, si e mbrojnë? Ndërkohë këtu në zonën tonë, zona bujqësore-blegtorale e gjithë Shqipërisë, më e mira, më e përparuara, do ndërtohet Termocentrali? Ku do shkojnë gjithë ai tymi i Termocentralit, e ka menduar ndonjëherë? E keni menduar që do bëheni pjesë e kësaj shoqate, e dinë vendet e rajonit, ato zona që do bashkohemi dhe ne bashkë me ta, në cilën situatë jemi ne këtu? Ne do mbytemi nga ai tymi, kështu e mbrojmë mjedisin ne duke ndërtuar Termocentrale? Duke vrarë jetën e njerzve, bimëve, kafshëve, çdo gjë të gjallë që ekziston në zonën tonë, kështu që jam shumë e paqartë. Dhe mbështetja e politikave lokale të qëndrueshme, cilat janë këto politika lokale që janë shumë të qëndrueshme për Bashkinë tuaj? Kaq kisha, faleminderit dhe duam një sqarim. Ulpiana- këto janë pikat që vet ACR-ja dhe shoqata e rajoneve të qyteteve operon, dhe duke qënë pjesë anëtare e saj, domethënë pjesë përbërëse e kësaj shoqate, Bashkia ka mundësinë që të bashkëpunojë në kuadër të projekteve të ndryshme që operojnë në fushën e mjedisit..Dhurata- cilat projekte konkretisht? Ulpiana- po se shoqatat gjatë gjithë kohës hapin thirrje të ndryshme..Dhurata- dhe bashkohemi ne harxhojmë ca lekë, ndërkohë më fal që këto lekë mund të hidhen tek ajo shkolla ime që është atje, që tre vite ska bërë akoma që është rikonstruktuar dhe muret po bien komplet, çka do të thotë kjo? Maksi- po ne sjemi bërë akoma? Dhurata- si, çka sjemi bërë? Po pse e kërkon atëherë? Maksi- të bëhemi njëherë anëtar, pastaj diskutojmë. Dhurata- meqënëse është dhe Nënkryetari këtu, se mirë do ishte të ishte dhe Kryetarja, tani këto fonde të lutem shumë, a i harxhon diku që ja vlen, kryesisht në ato shkollat tona që u dogjën të gjitha ato panelet çka janë ato lartë të energjisë elektrike, ska fare drita, tualetet janë akoma pa ujën e ngrohtë, skanë qënë gjithë dimrin, së treti muret e shkollës 3 vite e ndërtuar shkolla, muret po bien copa-copa, janë bërë prapë gropa-gropa muret, është turp si para çlirimit, dhe së katërti ato rrugët e fshatit janë berë copa-copa, më përpara u prishën sesa u ndreqën, çara-çara, janë bërë kanale-kanale rrugët. Atëherë ne kërkojmë të bëjmë këto shoqata për tu dukur, për tu mburrur, për të shpenzuar këto lekë kot pa kriter, jo mua smë duket e drejtë. Maksi- ky është mendimi juaj..Dhurata- po jo ta mendoni edhe ju, pse i harxhoni kot këto lekët, është për të ardhur keq. Ndërkohë merrni një filtër vendoseni te ato depot e ujit se po vjen uji llum i kuq, do ta nis me video se i kam dhe këtu, se u bëmë bajat ne herë pas here nis video koshat e plehrave, nis mjediset e shkollave, nis rrugët, nis ujën e ndotur, tani u bëmë bajat edhe ne. Atëherë shpenzoi merr një filtër, kaloje në çdo depo uji, sa depo uji ka zona jonë, ka 6 apo 7, ja 10 i ka, merr një filtër..Maksi- ska të bëj me këtë..Dhurata- jo ska të bëj, mos u bashko me shoqatën, duhen këto lekët se në fund të fundit këto lekë ju i keni marr nga fondi i Bashkisë apo jo? nga fondi që është miratuar në 2025 nga ne, nga ne të PD-së jo po nga ju të Ps-së, se çdo gjë ju e miratoni

dhe bravo ju qoftë për këto gjëra që po bëni se e keni ndritur, por ama të venë lekët atje ku është e nevojshme, jo të shkojnë në destinacione kot pa lidhje, për tu dukur, për tu mburrur, për fasada që jemi dhe ne në këtë shoqatë ACR-je, unë kështu e gjykoj dhe kjo është më e drejta. Për këtë arsye unë jam kundra absolutisht, sjam dakort. Kryetari- po, faleminderit Dhurata, fjala është për ju..Viola- përveç anëtarësimi, çfarë të mirash do ketë Bashkia, komuniteti nëse ne antarësohemi ose bëhemi pjesë e kësaj shoqate? Një gjë konkrete që ta dimë, të jemi të qartë që po antarësohemi këtu, po çfarë të mirash do kemi nga kjo anëtarësi? Kryetari- ok, faleminderit Viola. Ulpiana- duke qënë se shoqata hap thirrje të ndryshme në kuadër të projekteve sepse ne mund ti shtojmë këto projekte pasi të jemi antarësuar, sepse ato gjatë gjithë kohës shpallin thirrje për projekt-propozime në fusha të ndryshme..Viola- a i plotësojmë ne kushtet për të qënë pjesë e këtyre projekteve, a kemi ne kapacitetet ose ato nevojat e domosdoshme për të qënë pjesë e këtyre projekteve, sepse shoqatat përcaktojnë projekte ose hapin projekte pafund? Ulpiana- varet nga lloji i projektit..Dhurata- po futemi ne kështu kot, të dukemi për fasada..Në sallë po flasim njëkohësisht Maksi dhe Dhurata..Kryetari- o Maksi të lutem që të mos flasim njëkohësisht sepse duhet të mbajmë dhe procesverbalin e mbledhjes ndërkohë..Ulpiana- ne i plotësojmë kushtet normalisht për të qënë anëtare tek kjo shoqatë, dhe pastaj në vijim në bazë dhe të thirrjeve të ndryshme që hapen, do duhet që ne të aplikojmë, Bashkia si institucion në varësi të thirrjeve të ndryshme që hapen nga shoqata. Kryetari- çështja ishte në qoftë se unë e kuptova drejtë, kemi ndonjë studim paraprak, e kemi parë ne karakterin e thirrjeve që hapet pikërisht nga kjo shoqatë? Kemi mundësi që ne të përfitojmë apo? Ulpiana- po sepse Bashkia është anëtare dhe në organizata të tjera..Kryetari- ok, atëherë kemi pasur raste që nga ato ne kemi fituar projekte? Ulpiana- po kemi pasur..Maksi- jo pak, po shumë projekte..Dr.Ekonomike Orgesa- siç ishte shkolla e rivitalizimit në Kurjan..Ulpiana- po rivitalizimi në Kurjan..Kryetari- mirë faleminderit për përgjigjen që i dhatë znj.Viola, dikush e kërkon fjalën, ka pyetje për specialisten në lidhje me këtë projekt-vendim? Fredi- diskutim kisha..Kryetari- për pyetje e kërkon dikush fjalën? Nuk ka. Kryetari- atëherë fjala është për diskutim për juve z.Fredi. Fredi- shiko ne si opozitë kemi rënë dakortë pavarësisht se kanë qënë fasada për të gjitha antarësimet e shoqatave, pavarësisht se ato janë simbolikisht 780 mijë lekë por kanë qënë fasada, nuk është se kanë përfituar. Shumë mirë e tha kolegja për ambientin, për projektet, po shumë kontrast bie gjithë ai Tec që po bëhet atje, që helmon gjithë botën, ne firmosim ca fletushka edhe ca lekë të tjera. Po bie shumë kontrast këtu sepse firmosim antarësimin në shoqatë ne dhe në të gjitha shkolla e Bashkisë nuk ka pasur ngrohje sivjet. Bie shumë kontrast, sot në fshatin Ngjeqar rastësisht ka vajtur fadroni për të hapur ca rrugë sepse është bërë katastrofë dhe kanë ngelur për naftë, do thuash ti 780 mijë lekë janë, jo 780 mijë lekë punon një muaj skrepi, dhe këto më duken shumë fasadë. Në qoftë se nuk janë këto që them unë, në një shkollë, në një kopsht këtu në Bashkinë tonë nuk ka wc, nuk ka karrige dhe ne merremi më shumë me fasada. Këto janë fakte që them unë dhe ta vërtetojë, kopsht marrin fëmijët karriget nga shtëpia dhe i çojnë atje, nuk ka wc, në kopsht wc gjynah 10 mijë lekë të vjetra, 20 dhe 780 mijë lekë? Kaq kisha dhe unë jam kundra, është fasadë komplet pavarësisht vlerës..Kryetari- faleminderit z.Fredi, fjala është për z.Maksi. Maksi- z.Fredi do më falësh por dua të replikojë përsa i përket problemit të ngrohjes së shkollave dhe kopshteve. Nuk ka pasur shkollë dhe kopsht fal dhe Zotit lartë që kanë qënë temperaturat, po unë nuk di të paktën në pozicionin që jam, që të ketë kopsht dhe shkollë pa ngrohje gjatë periudhës fundi i 2025-2026..Dhurata- ja konkretisht shkollën time, cikli fillor po qëndron, por nga cikli lartë asnjë, 8 klasa lartë asnjëra nuk kishte ngrohje sivjet..Maksi- edhe njëherë, është tjetër gjë pastaj që nuk kanë shkollat..Dhurata- sepse e ndezin 5 minuta në mëngjes atje edhe kaq mbaroi..Maksi- më

fal se e kisha me këshilltarin. E dyta përsa i përketë kopshtit, unë të ftoj të vemë ta shikojmë dhe në qoftë se kopshti..Fredri- po po absolutisht, në Jagodinë..Maksi- dhe në Jagodinë vemi..Fredri- qëndron apo nuk qëndron? Maksi- jo nuk qëndron për arsye se fakti që atje është vetëm kopshti, nuk ka as shkollë asgjë, të gjitha karriget, tavolinat e të tjera me radhë janë në dispozicion vetëm të kopshtit..Fredri- nuk ka karrige, i marrin fëmijët vet, nuk ka wc..Maksi- do vemi bashkë ta shikojmë..Unë nuk ta kthej dot mendjen tani por po them edhe njëherë, e gjithë baza materiale e shkollës së Jagodinës është në dispozicion vetëm dhe vetëm të kopshtit..Fredri- nuk ka zotri, nuk ka..Maksi- është mendimi yt, unë po them të kundërtën..Fredri- po mirë vemi tani..Maksi- po patjetër vemi, do vemi ta vizitojmë dhe të kthejmë përgjigje mbledhjen tjetër..Fredri- direkt pas mbledhjes të gjithë vemi..Maksi- po patjetër. Kryetari- faleminderit z.Maksi, dikush tjetër e kërkon fjalën për diskutim në lidhje me projekt-vendimin që jemi duke diskutuar? Nuk ka. Kryetari- ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin “Për anëtarësimin e Bashkisë Roskovec në Shoqatën e Qyteteve dhe Rajoneve për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Burimeve (Association of Cities and Regions for Sustainable Resource Management / ACR+)”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin si më sipër dhe miratohet me 10 vota pro, dhe 4 vota kundër F.Feleqi, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, V.Çepele. Kryetari- atëherë miratohet ky projekt-vendim me 10 vota pro dhe 4 kundër.

6.Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026.

Kryetari- atëherë përmbledhtas. Dr.Ekonomike Orgesa- të nderuar këshilltar, jam para jush për të prezantuar projekt-vendimin “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”, në buxhetin e miratuar në fund të Dhjetorit të vitit 2025. Kemi miratuar zërin investime për mbulim kanali me gjatësi 250 m linear në fshatin Kuman, nga ekspert të fushës u pa e arsyeshme se nuk kishte nevojë që ky zë të bëhej investim, po thjesht vetëm blerje materiale me të njëjtën vlerë, me të njëjtën gjatësi dhe puna të kryhej nga punonjësit e Agjensisë së Shërbimeve Publike të Bashkisë. Unë i rashë shumë shkurt, nëse doni pastaj të lexoj gjithë relacionin, është thjesht vetëm ndryshim nga llogaria 602 që do bëhet blerje materiali në investim. Kryetari- faleminderit Orgesa, po fjalën e ka Dhurata për pyetje. Dhurata- jo unë e kisha në forëm pyetje në fakt, kanali që ishte do filloj tubacioni apo çfarë? Isha e paqartë. Orgesa- do vendosen tubo dhe do mbulohet kanali..Dhurata- jo se e di ku e kam hallin, se e njëjta gjë u bë dhe në fshatin Suk 1 në lagjen Agaçaj kryesisht, u shtrua dhe rruga atje dhe ndërkohë ne e miratuar të gjithë unanimisht këtu në Këshill për bërjen e asaj rrugës atje, dhe kanali do bëhej me bankinë por erdhi momenti me zor u bë ajo rruga 2 metër e 20 centimetër, se më gjerë nuk u bë dhe vjen momenti tani ngeli me aq, as kanal su bë, as nuk u pastrua i shkreti kanal ndaj po them unë, që do shkoj i gjithë fondi atje apo do bëhet siç ndodhi në Agaçaj? Orgesa- jo fondi do vazhdojë me procedurë prokurimi, thjesht do kalojë nga investim që ishte parashikuar, do bëhet vetëm blerje materiale, ndërsa mbulimi i kanalit me këto materiale që do blihen do bëhet nga punonjësit tanë. Dhurata- po shpresojmë të bëhet se mos ndodh e njëjta strukturë siç ndodhi në Agaçaj. Kryetari-tjetër kush për pyetje e kërkon fjalën? Për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim? Atëherë kërkesë për diskutim nuk kemi, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet

unanimisht me 14 vota pro. Kryetari- me të gjithë vota pro të këshilltarëve të pranishëm miratohet ky projekt-vendim. Faleminderit znj.Orgesa.

7. Për një shtesë në Paketën Fiskale për vitin 2026.

Kryetari- ftoj z.Selman Çepele që të na bëj një relacion përmbledhës për këtë pikë. Do doja që tju kujtoj që për këtë projekt-vendim është dashur nga ana e administratës por edhe e Këshillit që të bëhen dy dëgjesa publike, është depozituar dhe një kërkesë nga ana e kompanisë që është e interesuar ose që preket nga ky projekt-vendim, kështu që përmbledhtas do doja që z.Selman të na përfshijë në këtë relacion dhe një kthim përgjigje që i është bërë kompanisë përkatëse, përpara se ta hedh këtë projekt-vendim në votim. Selmani- u paraqesim këtë ndryshim ose më mirë të themi shtesë në paketën fiskale të vitit 2026, të miratuar më parë. Në lidhje me ndryshimin në kapitullin 2 të tarifave vendore, pika 2/3 “tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për bizneset dhe institucionet” dhe ky vendim ishte marr paraprakisht edhe në disa vite të mëparshme, në mënyrë të njëpasnjëshme, por kjo tarifë e vendosur për bizneset dhe institucionet ishte stopuar deri në vlerën 200 milion për investimet, dhe lind nevoja që në bazë të investimeve të filluara dhe të kërkesave të bëra, neve të vazhdonim që të përcaktonim tarifat përkatëse edhe për investime më lartë se 200 milion. Kemi bërë një ndarje duke i rënë llogjikës proporcionale, që në bazë të rritjes, kjo taksë nga 5 milion lekë deri në 200 milion, në mënyrë të zhdrejtë të bëhet rritja edhe në vlerën nga 200 milion deri në 15 miliard lekë dhe më tutje. Them në mënyrë të zhdrejtë sepse me rritjen e vlerës së investimit, rritja për njësi të tarifës, për njësi investimi të kësaj tarife është më e vogël, pra me rritjen e investimit rritja për njësi investimi është më e vogël. Kemi menduar dhe duke iu përgjigjur dhe kërkesave të bëra dhe ankesave të bëra nga firmat përkatëse, që kjo rritje nuk është kolosale siç e përcaktonin ata dhe e papërbalueshme për nga vet ata. Është rritur vlera sepse për investim më të madh është vendosur një tarifë më e madhe llogjike, dhe mendojmë që në bazë të këtyre materialeve që ne kemi sjellë, u kërkojmë miratimin e këtij projekt-vendimi dhe vendosjen e kësaj tarife, e cila do ti shërbejë padyshim zhvillimit ekonomik të Bashkisë dhe të administrimit sa më të mirë të taksave dhe tarifave vendore. Kryetari- pra po na thoni që ne kemi të bëjmë jo me shtesë zërash..Selmani- me shtesë të një zëri të miratuar më parë..Kryetari- shtim kategorish? Selmani- shtim kategorish të zërit të miratuar më parë. Kryetari- ky zë ka qënë pra tek tarifat..Selmani- tek tarifat të miratuara disa vite me radhë në paketën fiskale..Kryetari- pra si zë tarifash ky është quajtur i ligjshëm nga Prefektura në të gjithë paketat..Selmani- i ligjshëm nga Prefektura. Kryetari- dhe ne thjesht kemi shtuar kategorinë..Selmani-po. Kryetari- po faleminderit, po fjala është për ju z.Leksi. Leksi- jo një redaktim këtu që mund ta bësh tek paragrafi i fundit, unanim jo anonim, një redaktim se atë e ezaurove ti. Dhurata- unë do thoja kështu, nëse nuk bëhen ndryshime çfarë do ndodhi? Nëse do ishin atje ku kishin qënë si vlera? Maksim- nuk do paguaj taksa investitori. Dhurata- pse deri tani nuk kanë paguar taksa ata? Maksim- kanë paguar po deri tek ajo tarifë që është e përcaktuar aty tek vendimi. Dhurata- po pse duhet të rritet tarifa? Maksim- për arsye se është investim më i madh, në qoftë se ne kemi miratuar 6 kategori..Dhurata- ku është verifikuar investimi më i madh? Fredi- kush është investitori? Maksim- investitorin nuk e dimë, deri tani ska ardhur investitor, ne përcaktojmë tarifat me kategori, nga 1 deri në 100 lekë, nga 100 lekë deri në 200 lekë, nga 200 lekë deri me milion lekë dhe këtë e kemi..Fredi- konkretisht ka? Selmani- po se ishte stopuar tek 200 milion lekë investime, tani lind nevoja që do kryhen investime më të larta, mbi 200 milionshin..Maksim- kur investimet kryhen më të larta, ne kemi marr analogjinë dhe

Bashkinë e Tiranës, Bashkinë e Fierit e të tjera me radhë, që sa më i lartë të jetë investimi, aq më e lartë është tarifa për mbetjet në këtë kategori dhe ne deri dje ngaqë nuk kishim investime..Fredimbase dhe i penalizojmë sepse kush e di se mos ne kemi..Dhurata- mund të përfitojnë ata por gjithsesi..Maksi-jo sdo përfitojnë, do përfitojë Bashkia në këtë mes në qoftë se ata do paguajnë..Dhurata- patjetër tek ju do vijnë ato, Bashkia do i vjeli sigurisht po dhe për investitorin gjynah..Maksi- investitori gjynah? Dr.Ekonomike Orgesa- është kjo ndotja që po shkakton..Dhurata- po ndotje më të madhe se Termocentrali ske ku gjenë në të gjithë globin..Maksi- po për atë bëhet fjalë..Fredim- po unë po ta them kush është ju e mbani akoma..Në sallë ka zhurëm dhe po flasin njëkohësisht. Kryetari- ju lutem të flasim me radhë se nuk po arrijmë dot që të rezervojmë fjalën tuaj, ju lutem të flasim me radhë..Maksi- nesër mund të ketë investitor të tjerë më të fuqishëm sesa ajo tabelë që kemi vendosur ne, dhe tarifat vendore do të jenë më të larta. Kryetari- po faleminderit z.Maksi, dikush nga këshilltarët kërkon fjalën për ndonjë pyetje në lidhje me këtë projekt-vendim? Për diskutim? Atëherë pyetje dhe diskutime nuk ka, ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin “Për një shtesë në Paketën Fiskale për vitin 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe me 10 vota pro, dhe 4 vota abstenim F.Feleqi, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, V.Çepele nuk miratohet ky projekt-vendim. Kryetari- për këtë projekt-vendim na duhej që ta miratonim me 11 vota, kështu që ky projekt-vendim nuk miratohet.

8.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari- ashtu sikundër e kemi lënë në mbledhjen e kaluar, është kërkuar nga një pjesë e madhe e këshilltarëve një forëm llogaridhënie nga Drejtoria e Investimeve këtu në Këshill, dhe do doja që pikërisht këtë pikë ta fillonim atje ku e kemi lënë, në përgjigje të pyetjeve të këshilltarëve që janë rezervuar që përpara dy mbledhjesh të këtij Këshilli. Fredim- fillojmë me pyetjet apo me përgjigjet? Dhurata- jo do marrim përgjigjet njëherë.. Kryetari- po presim që të vijnë dhe specialistët që të marrin përsipër dhënien e përgjigjeve. Leksi- ne kërkuam që të vij një material nga zyra e investimeve dhe të ishte personi që ta interpretonte, drejtori. Kryetari- atëherë të lexojë pyetjet që janë rezervuar. Pyetja 1 është informacion në lidhje me afatet e fillimit dhe mbarimit të punimeve që kanë firmat në zbatimin e projekteve. A kanë qënë korrekt? Në rast se nuk kanë qënë korrekt, a ka pasur..Leksi- në respektin më të madh për punonjës, jo për nga niveli i shkallës së hierarkisë, këtu nuk ka qënë ky pjesmarrës, supervizor a nuk e di në pjesën e investimeve apo jo? Kështu që pse duhet ta marri ky përsipër përgjigjet e pyetjeve që kemi nisur ne për investimet në Bashkinë Roskovec? Maksi- a kërkuat përgjegjësin e zbatimit të investimeve? Sektor është nuk është drejtori..Leksi- drejtori është, ka supervizor..Maksi- jo nuk është drejtori, nuk kanë supervizor, nuk është në organikën e Bashkisë. Në qoftë se thua supervizor është tjetër gjë tani, kërkon specialistin e investimeve? Leksi- ndër vite ky ska qënë..Maksi- po nuk është e thënë tani, institucioni ai është..Leksi- megjithatë materiali duhet të ishte para kohe i shpërndarë..Kryetari- në qoftë se administrata ka pasur kohën e mjaftueshme që të përzgjedhi personat që do të japin përgjigje, gjithsesi të vlerësojmë që këtu kemi Nënkryetarin e Bashkisë dhe për çdo plotësim, besoj se do të jetë i mundur për të plotësuar përgjigjet në qoftë se nuk do jetë e kënaqshme, dhe në vazhdim të pyetjes Nr.1 në rast se nuk kanë qënë korrekte, ka pasur penalitete? Çfarë lloji kanë qënë penalitetet? Në rast se puna nuk ka qënë cilësore, a është marr në dorëzim apo jo? Cilat janë afatet kohore deri në marrjen ose jo në dorëzim të punimeve nga Bashkia? Informacioni kërkohet për

periudhën që nga viti 2023 dhe në vazhdim. Dhurata- shumë mirë e ka bërë, përgjigja cila ishte? Leksi- është pyetja që kam bërë unë..Dhurata- shumë mirë ke bërë, ta marrim vesh ne se kur kërkojmë ne llogari..Leksi- ta shtjellojë si pyetje, pastaj..Kryetari- të lutem, sepse pyetja mund të jetë shumë e qartë për specialistin, kështu që..Leksi- ta shtjellojë, le ta marri me argument ku janë këto pjesët, vazhdo, mirë dakort..Kryetari- atëherë të dëgjojmë specialistin dhe në qoftë se ka ndonjë paqartësi ose ka ndonjë moskuptim të saktë të pyetjes që ju keni bërë, do ta ridëgjojmë..P/Investimeve Aldi- atëherë përsa i përket investimeve që nga 2023, unë nuk mund të përgjigjem sepse nuk kam qënë. Unë përgjigjem për periudhën që kam qënë si specialist i sektorit..Leksi- prandaj thashë dhe pa të fyer sepse nuk ke qënë në atë periudhë, me respektin më të madh dhe të falenderoj që erdhe..Maksi- ti përfaqëson institucionin jo Aldin, institucioni atje i ka shkresat..Aldi- unë flas për periudhën që kam qënë unë..Maksi- po jo kur ke qënë ti, flet institucioni, dokumentat i ke lart po megjithatë vazhdo përgjigju për atë..Kryetari- z.Maksi të lutem në qoftë se specialisti që ju keni sjellë për të dhënë përgjigjen nuk është i duhuri, ju japim kohë që të sillni dikë që mund të na japi përgjigje për pyetjet që kemi shtruar. Leksi- meqënëse është pjesë e kësaj, ju Nënkryetar do ti përgjigjeni pyetjeve? Maksi- patjetër. Kryetari- po fjala është për z.Maksi. Maksi- specialisti është përgjegjës i ndjekjes së investimeve, nuk është drejtori, deri dje ai sektor është mbuluar nga persona të tjerë, po ska shumë rëndësi, për mua i gjithë dokumentacioni është në zyrën përkatëse që ndiqet. Deri më sot përsa i përket investimeve kryesore, unë nuk do them të gjitha investimet se skam mundësi të them, po investimet kryesore janë: nënstacioni i pompimit të ujit të Matkës për në kënetën ose rezervuarin, që është jashtë afateve kohore; është fusha e sportit që është jashtë afateve kohore; është investimi i rrugëve të lagjeve të vitit 2025 që është jashtë afateve kohore..Dhurata- dhe 2024, 2023..Maksi- tani të lutem se po flas për 2025, tani po më pyet mua apo djalin? Dhurata- të 2025 se ato ikën, të shkuara të harruara, se fondi hidhet se ku vete ai fond, se zbatohet çerek fondi dhe pjesa tjetër pastaj fluturon në ajër..Kryetari- znj.Dhurata të lutem me radhë që të kemi mundësi të sekretojmë fjalët tuaja..Maksi- po flas për investimet kryesore që kanë qënë në Bashkinë e Roskovecit, tre janë investimet që nuk janë zbatuar në kohë, ndërsa përsa i përket gjithë zbatimeve të tjera kanë filluar penalitetet. Ka qënë dhe një investim, jo investim por blerje për aktivitete sportive, jemi në proces gjyqësor, ndërsa për të treja këto përsëri kemi hapur proces dhe kemi filluar penalitetet sipas afateve kohore pas përfundimit të çdo investimi. Ka pasur dhe shtyrje për problematika të motit të keq për nënstacionit të Matkës dhe të lumit Seman të pomës, ka pasur dhe shtyrje në bazë të ligjeve në fuqi, ndërsa sot që flasim bashkë kemi filluar penalitetet sipas grafikëve të punimeve, për ndjekjen ligjore të të gjitha procedurave. Po të njëjtën gjë kemi dhe me rrugët e lagjeve, janë dy investitor që nuk janë marr në dorëzim për 2025, nuk është paguar 5%-shi, biles dhe shlyerja e gjithë situacioneve përkatëse nuk është bërë për rrugët e parcelave dhe lagjeve, jemi dhe tek 5%-shi që do ti qëndrojmë strikt detyrimeve ligjore dhe afateve, për të filluar penalitetet sipas ligjit në fuqi. Në qoftë se ke ndonjë investim konkret dhe mund të ma thuash. Leksi- ju e filluat nga viti 2025, të cilat këto janë çik më të hershme për shkak dhe të investimit që u bë në ujësjellës, dhe shkaku kryesor i dëmtimit konkret të rrugëve, ndoshta janë marr edhe në dorëzim nga Bashkia, është investimi që është bërë në ujësjellës dhe nuk e di kjo firmë është penalizuar apo jo, sepse disa herë e kam ngritur këtu dhe nuk kanë ndinjuar domethënë që të kthejnë ato ku kanë bërë çarjen ose difektin atje, ti rikthejnë në gjendjen e mëparshme rrugët, dhe të gjitha rrugët në pjesën dërrmuese në Bashkinë e Roskovecit janë të dëmtuara nga ndërhyrjet që janë bërë në ujësjellës, një. Kjo flet për cilësinë e dobët të punës, ndaç të firmës përgjegjëse që ishte të ujësjellësit, ndaç dhe atyre më

mbrapa. Tani firma e ujësjellësit nuk e di është penalizuar apo nuk është penalizuar dhe nuk e di se kush është si firmë nuk më intereson fare, po unë në radhë të parë sjam këshilltar, jam qytetar të cilët më vjen keq për të gjitha rrugët që janë ndërtuar dhe janë investuar, janë dëmtuar të gjitha, pjesa më e madhe mos të them 90% për rrugët e dëmtuara. Tani flasim për investimet e tanishme që nuk e kanë kapur afatin kohor. Disa herë dhe këtu në mbledhje të Këshillit kam thënë që nuk vendosen afatet e zbatimit, domethënë datat e fillimit të punimeve dhe e mbarimit të punimeve, vetëm thjesht vendosen në mënyrë evazive, domethënë që mbarimi i punimeve 6 muaj nga fillimi i punimeve, pa vënë datë të caktuar. Dhe këtu e kemi të qartë për fushën e sportit të cilët në 6 muaj që duhej të mbaronin punimet, ka vajtur deri në 12 muaj pra 2-fishin e kohës, dhe më vjen keq dhe si firmë mesa shikoj, më ngjan si firmë shumë e lodhur pa të ardhura. Aty shikoj ditë për ditë nga një punëtor ose nga dy punëtor dhe aty kur vijnë ditët e Diela, kur të tjerët janë pushim ata punojnë ditët e Diela. Shikoj një skrep të ndryshkur, shikoj një rrul të vogël të ndryshkur, domethënë nuk e shikoj këtë firmë serioze që të mbarojë një investim të cilin ne e kemi kaluar me dëshirë dhe me qejfin më të madh që ti shërbejë komunitetit. Kemi rrugën e liqenit të Kurjanit, pa u vënë në funksion akoma në shumë pjesë të saj është e dëmtuar dhe ndiquesët aty janë vendosur në tre vende një ose në dy vende një. Nuk e di është mbaruar, është marr në dorëzim se di? Dhe degëzimi i asaj rruge që të çon tek familjarët lart tek Adushët, është një rrugë domethënë që para se të vihet në funksion ajo është tej mase e dëmtuar dhe nuk e di se kush firmë e ka bërë atë. Pra në të gjithë atë një emërues i përbashkët këtu, puna e dobët që kanë bërë dhe pse investimet janë të mëdhaja, puna e dobët e firmave, cilësi shumë e dobët dhe nuk e di kanë penalitete këto firma a skanë, dhe 5%-shi që për ata mund të quhet i papërfillshëm në një investim prej 200 milion lekësh të vjetra, edhe mund ta lëmë atë 5%-shin po dëmi këtu bëhet i madh, bëhet i komunitetit dhe i pjestarëve që jetojnë dhe që e përdorin këtë rrugë. Tjetër dhe rruga pas Overit, u bë një rrugë tej mase e dëmtuar, nuk e di se kush firmë ka punuar në këtë. Pallati banesë sociale që është tek shkolla 9-vjeçare , të cilët akoma 2-3 familje nuk janë futur për shkak të difekteve, anomalive të jashtëzakonshme si në rrjetin elektrik dhe në rrjetin e ujësjellësit. Disa herë i kemi bërë thirrje, kanë arritur deri sa aty tani është privat, domethënë e kanë privat ndërkohë që privatët nuk kanë hyrë akoma dhe nuk e kanë gëzuar atë banesë sociale. Unë këto kisha, këto janë për Bashkinë e Roskovecit. Maksi- unë i mbajta shënim të pesta problematikat kryesore që ju ngritët..Kryetari- faleminderit z.Leksi, tani të dëgjojmë z.Maksi. Maksi- investimi i parë ishte investimi i ujësjellësit, i përfunduar në vitin 2024. Përsa i përketë rrugëve është problem që është konstatuar dhe nga ana jonë, janë marr dhe masat konkrete, janë vendosur 20 gjoba në rrugët e Roskovecit, brenda për brenda Roskovecit, sipas tarifave dhe taksave vendore nga 200 mijë lekë për çdo gjobë dhe janë paguar nga investitori. Njëkohësisht është bërë riparimi dhe i rrugëve atje ku ka qënë e domosdoshme për tu bërë, por gjobat janë vendosur dhe janë marr masat konkrete. E dyta tabelat dhe afatet kohore ka qënë një kërkesë e juaja e Këshillit, nuk po flas me emra për këtë, ka qënë mbase lapsus nga ana jonë që thoshim brenda 6 muajve, pas asaj të gjitha tabelat janë me investitor, me TVSH plus dhe afatet kohore..Leksi- datë fillimi – datë mbarimi? Maksi- datë fillimi-datë mbarimi të gjitha investimet, datë fillimi-datë mbarimi pas asaj kërkesë që është bërë këtu në Këshillin e Bashkisë. Leksi- tek pjesa e rrugëve tek liqeni? Maksi- rruga e liqenit ka qënë një rrugë që është bërë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me bazë materiale, punimet janë bërë nga ana jonë si Bashki, ka përfunduar në 31 Dhjetor të 2025, atje ku ka dashur unë di që janë bërë dhe ndriçimet, janë bërë fasadat për biçikletat, fasadat e kalimit trotuari. Nesër është 1 Maji që do vemë të festojmë së bashku, do të jetë një ditë ku do kalojnë makina, do kalojnë këmbësor, besoj se ato korrigjime që duhen bërë do

jemi shumë pranë afatit për ti korigjuar, është një rrugë që do ti shërbejë qytetarëve të Roskovecit..Leksi- është marr në dorëzim? Maksi- edhe njëherë, punimet janë bërë nga Bashkia në 31 Dhjetor, nuk është marr në dorëzim dhe në qoftë se do të duhen korigjime, brenda 6 muajsh ato korigjimet që duan bërë do i bëjmë përsëri ne si Bashki..Leksi- po vajti 2 muaj spo hiqet dhe atje ku ka rënë..Maksi- po mirë unë spo them që nuk ka problematika, po mos harro tani dhe rëshqitjet por kemi pasur dhe ne probleme të tjera, nuk po them që është marr në dorëzim, nuk po them që ka filluar plotësisht..Leksi- edhe rruga tek degëzimi tjetër, kush e ka investuar rrugën degëzuese, domethënë rruga kryesore e liqenit, degëzimi që të çon tek familja Adushi lart..Maksi- tek romët? Leksi- jo tek romët jo, më lart..Maksi- mbi trotuarin..Leksi- jo trotuar, është rrugë, rrugë me asfaltobeton..Maksi- tjetër rrugë, mirë dakort..Përsa i përketë rrugës së Overit, the mbrapa Overit, jam plotësisht dakort me ty, i është vendosur gjobë atij. Kemi bërë një projekt tani dhe për atë pallatin atje, i riu që është bërë nga Enti i Banesave, për ti bërë një lulishte, sistemim e të tjera me radhë, do ta kalojmë këto ditë. Njëkohësisht dhe për rrugën është vendosur gjobë, pikërisht për rrugën që e përdorin për të mbajtur bazën materiale ai investitori i Entit të Banesave, është bërë dhe gjobë dhe personit konkret, domethënë investitorit. Vazhdojmë me pallatin e banesave sociale tek shkolla 9-vjeçare. Përsa i përketë atij atje ne jemi një komunitet që ai u bë për familjet në nevojë, kryesisht shkon komuniteti rom dhe atje ka pasur problematika vetëm me ujrat e zeza, me bllokimin e vazhdueshëm dhe me hapjen e tubacioneve të shkarkimit të ujrave të zeza, nuk ka pasur problematika për grasi e të tjera me radhë por ka pasur vetëm këtë. Ne si Bashki atij që bëri punimet firmës private i jemi drejtuar disa herë, ka ardhur brenda afateve kohore i ka bërë punimet, tani ka dhe një gjë, unë thashë që është komuniteti rom..Leksi- nuk është vetëm komuniteti rom..Maksi- ka dhe komunitet të bardhë atje, por ato tubacionet e ujrave të zeza i gjejmë me rroba apo mos të flasim më shumë se kaq..Leksi- është tjetër gjë ajo, atë mund ta bëjmë edhe ne se bën vetëm komuniteti rom..Maksi- pra komuniteti duhet ta mirëmbajë atë si banesë..Leksi- janë dy familje që nuk kanë hyrë fare për arsye sepse që në momentin e parë tavanet rridhnin, domethënë ishin çarë të gjitha tubot brenda, instalimet e ujrave, çezmave..Maksi- ka pasur problem me ujrat, thashë kemi ndërhyrë..Leksi- po pra, se ka arritur deri atje sa kishte zënë korenti dikë tjetër..Maksi- mund të ketë qënë dhe cilësia e dobët e punimeve..Leksi- po, cilësia e dobët është..Maksi- por problem kryesor është mbajtja pastër e wc-ve të tualeteve atje..Leksi- ajo është tjetër gjë, është edukatë ajo. Megjithatë unë si qytetar pastaj si këshilltar dakort jam me përgjigjet por nga gjobat që janë vënë nuk shikoj ndonjë ndryshim tek rrugët atje ku janë bërë..Maksi- thashë janë vënë 20 gjoba..Leksi- në rregull 20 gjoba, nuk shikoj ndonjë ndryshim, ça efekti ka kjo për komunitetin, që ça do bëhet? Maksi- pjesa më e madhe u bënë riparim si nga lagjja poshtë, dhe këtej pjesa më e madhe u bë..Kryetari- faleminderit, fjalën e ka kërkuar Elizabeta pastaj znj.Dhurata, ose në qoftë se doni mbase ju ndihmon fakti që unë t’jua lexoj njëherë përgjigjet zyrtare që na kanë kthyer, dhe këtu pastaj mund të shikojmë dhe punën e mirë që kanë bërë specialistët për kthimin e përgjigjeve, janë në nivel të kënaqshëm sipas pritshmërive tuaja që keni bërë pyetjet apo jo..Kryetari lexon edhe njëherë pyetjen e parë të bërë nga Leksi. Kryetari- duket se pyetjet janë shumë preçize dhe shumë të sakta kurse përgjigjet që unë po e lexoj ngelet ti vlerësoni ju vet, janë evazive apo janë përgjigje edhe këto po aq preçize sa pyetjet. Kthim përgjigje: nga periudha Tetor 2025 e deri më sot ku ushtroj detyrën si përgjegjës i sektorit të monitorimit dhe zbatimit të kontratave, për afatet e fillimit dhe të përfundimit të punimeve janë ndjekur në përputhje me kushtet kontraktuale. Në rastet e konstatuara të mos respektimit të afateve, janë zbatuar penalitetet e parashikuara në kontratë, se cilat janë nuk kemi asnjë të dhënë. Janë zbatuar penalitetet e parashikuara në kontratën

me natyrë financiare, penaltete për çdo ditë vonesë deri në përfundim të punimeve, prapë nuk kemi asnjë rast konkret. Në rast kur janë evidentuar mangësi cilësore, punimet nuk janë marr në dorëzim nga komisioni përkatës, prapë dhe për këtë nuk kemi ndonjë referencë, deri në korrigjim përmbylljen e plotë të tyre nga subjekti zbatues. Proçedura e marrjes në dorëzim të punimeve nga komisioni përkatës kryhet në përputhje me kontratën dhe legjislacionin në fuqi. Tani kjo është përgjigja që na ka ardhur për këtë pyetje, pastaj në qoftë se i kënaq apo jo pritshmëritë le të ngelet në gjykim të këshilltarit i cili ka bërë këtë pyetje. Një pyetje tjetër është informacion në lidhje me zbatimin e vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.58 datë 30.09.2024 “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Roskovec dhe Agjensisë Shtetërore të Kadastrës”. Kthim përgjigje: Sa i përket pikës 1/b, vendimi i parë u përmbyll në bashkërendim me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, duke marr forëm në një marrëveshje me afat 1-vjeçar. Më pas kjo marrëdhënie institucionale ku u riformulua përmesë një marrëveshje të re në datën 13.01.2026, e cila u pasua nga Urdhëri i Kryetarit Nr.71 datë 03.04.2026. Në vijim të kësaj, proçesi ka hyrë në një fazë konkrete zbatimi, ku puna në terren ka nisur përmesë inspektimeve përkatëse. Pra unë nuk e shoh gjëkund produktin e atij vendimi që ne kemi marr këtu..Leksi- është në vija të përgjithshme por jo specifike..Kryetari- po, njëkohësisht nuk shikojmë produkt përkatës..Maksi- dhe këtë të Kadastrës mund ta plotësojë shumë mirë. Për arsye se ishte një Vendim i Këshillit të Ministrave të vitit 2024, mos gaboj në 30.09.2024 dhe ky Vendim i Këshillit të Ministrave kërkonte që të punësoheshin pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës 4-5 punonjës nga Roskoveci, të paguheshin nga Roskoveci, nuk u gjetë një marrëveshje e tillë. Sivjet në 2026 është lidhur marrëveshja, që dy punonjësit që janë të Bashkisë së Roskovecit të merren dhe me matjet çdo javë, ne marrim 4-8 dokumentacion të aplikimeve që janë bërë të të gjitha viteve dhe sot jemi para një fakti të tillë nga 1070 mos gaboj aplikime për legalizimin e të gjitha objekteve të ndërtuara, po punojmë me zona prioritare të Strumit dhe Roskovecit, të cilët kishin më shumë dhe puna ka filluar normalisht dhe vazhdon këto ditë, dhe do të vazhdojë sipas zonave prioritare për ti mbyllur të gjitha të 1070 kërkesat që janë. Dhurata- më fal, po këta dy punëtorët që do jenë, çka do jenë inspektor? Maksi- këta dy punëtorë janë punëtorët që do bëjnë matjet, do marrin dosjet..Dhurata- çka matje do bëjnë ata? Maksi- matjet e sipërfaqeve të legalizimit, pasi bëhet vetdeklarimi bëhet dhe matja e sipërfaqes në vend fizikisht dhe pastaj plotësohet dosja..Dhurata- pronë private? Po ne po flasim për gjera shtetërore si depot e ujit, shkollat, godinat..Maksi- po flasim për legalizimin jo për depot e ujit..Ndërsa dhe këtë meqë jemi këtu, dhe për legalizimin e gjithë pronave të Bashkisë dhe pyetje të Bashkisë, dhe për këtë po ecet por nuk po ecet me ato hapat që duhet ecur për arsye se kemi shumë objekte që nuk janë marr çertifikatat e çertifikimit të ndërtesave, me ato po punohet, qoftë dhe me gabinet elektrike e të gjitha me radhë dhe jemi duke punuar vazhdimisht. Leksi- Nën kryetar matje ka pasur, matjet janë bërë këtu e 1 vit dhe akoma lejet e legalizimit nuk kanë dalë, domethënë vjen momenti që ne deri këtu arrijmë të bëjmë se kaq e kemi hapin ose ndoshta dhe burimet njerëzore që mund të kemi ne këtu, dhe thonë që dosjet janë te ASHK-ja.Tani kur një kontratë që bëhet..Maksi- nuk bëhet për të lëshuar Bashkia çertifikatë..Leksi- jo lejet e legalizimit jo..Maksi- ne bëjmë matjet, plotësojmë dokumentacionin..Leksi- dokumentacionin e plotë a duhet ta kërkojë ky inspektor, ky punonjës duhet ta kërkojë atë punën që ka bërë në terren? Maksi- po patjetër. Leksi- tani sa do zgjasi 1 vit, pafundësisht? Maksi- do ketë një rakordim..Leksi- jo spo them një rast se ka shumë raste të tilla..Maksi- ti po thua shumë, unë po them 1070, janë 1070 nuk janë pak, po çertifikatën nuk është kompetencë dhe autoriteti..Leksi- jo jo, spo marr çertifikatën e legalizimit se e ndajnë ata, a duhet ta ndjeki ky punonjës atë dosjen që ka çur atje, atë punën që ka

bërë në terren? Maksi- patjetër që do ta ndjeki, 20 ditë kemi që kemi filluar..Leksi- jo kemi 1 vit..Maksi- ato të parat u mbyllën..Kryetari- faleminderit, gjithsesi referuar dhe relacionit të atij projekt-vendimi që unë mendoj se e kujtojë shumë mirë, pra pikërisht vendimin 58 datë 30.09.2024, në këtë sallë na është thënë që kjo vendimmarrje duhej sepse do kishim rezultate konkrete. Besoj se këtu duhet të kishim të paktën një rast që ishte përmbyllur proçedura..Maksi- jo mo janë mbyllur, jo vetëm 1 rast..Fredri- është ajo që thamë ne, që është për fushatë..Në sallë ka zhurëm dhe po flasin njëkohësisht disa këshilltar. Kryetari- nuk ka nevojë të bërrtasim, të lutem mund ta thoni mendimin tuaj qartë? Fredri- unë e kam kundërshtuar vendimin që mori znj.Kryetare atëherë sepse ASHK-ja i ka punonjësit, ska nevojë fare sepse punonjësit që do çojmë ne nuk kanë të drejtë as firme, as matjesh. Në qoftë se do masin nuk janë as specialitë për matjet, nuk do tu njihet as firma asnjë gjë absolutisht dhe na është thënë nga Kryetarja që nuk do tu njihet..Maksi- tani u njihet..Fredri- po mirë mbase me kalimin e kohës do tu njihet se nuk kanë bërë asnjë dosje ata, kjo është bërë vetëm për fasadë, për të punësuar. Megjithatë unë kisha dhe jashtë kësaj, kisha dhe një pyetje, kemi mbaruar? Kryetari- jo, ta mbarojmë se kam gjithë kthimin e përgjigjeve. Gjithsesi unë bie dakort që skanë shkuar proçedurat deri në fund, jam në dijeni të faktit që ka shumë proçedura që janë plotësuar dosjet dhe do doja që në kthim të kësaj përgjigjeje aty të përfshiheshin të gjitha ato, nuk janë përfshirë. Për këtë e ngrita problematikën dhe jo se nuk është punuar në atë drejtim. Jemi me një tjetër problem, tek pallati i naftëtarëve poshtë është çarë soleta dhe rrezikohet rënia e tavanit, çfarë bie jashtë bie dhe brenda, banorët e këtij pallati..Leksi- e kam marr përgjigjen nga Nënkryetari që është privat, është investim privat..Kryetari- është privat dhe duhet investim privat, nuk ka nevojë që ta lexojë? Leksi- nuk është emergjente..Kryetari- 2: Shqetësim në lidhje me ndriçimin në një pjesë të komunitetit të lagjes Nr.2, pjesa e shtatores me kandar deri tek liqeni i Kurjanit, atje nuk funksionon fare ndriçimi, mund të ketë 7-8 muaj, besoj se edhe kjo u ezaurua? Elizabeta- e kam bërë unë këtë pyetje muajin e parë dhe nuk e di domethënë, ende nuk ka marr zgjidhje problemi, ka gati 1 vit që është pa ndriçim ai segmenti i rrugës, nga shtatorja me kandar deri tek rruga e liqenit nuk ka ndriçim..Kryetari- atëherë po ua lexoj përgjigjen zyrtare : Përsa i përketë ndriçimit në lagjen Nr.2 nga pjesa e shtatores së kandarit deri tek rruga e liqenit, ju bëjmë me dije se për shkak të shtimit të ndriçimit në atë zonë, ndërmarrja ka bërë kërkesë për shtimin e një pikëlidhje të re dhe të ndahet në dy pjesë ndriçimi sepse sahati aktual nuk e përballon ngarkesën e linjës elektrike, dhe jemi në përgatitje të projektit nga ana e Bashkisë. Elizabeta- nuk e dimë sa kohë do zgjasi projekti dhe ajo çështje duhet të marrë zgjidhje sa më shpejtë, këtu qëndron problemi. Maksi- përgjigjen unë pak a shumë sot ua dhashë, po ua jap prapë dhe në Këshill dhe është po e njëjta përgjigje. Atje ka një gjë, nuk mban ai sahati atje, nuk mban limitatori dhe për këto arsye nuk kemi fuqi ne si Bashki dhe do bëjmë kontratë të re. Kemi bërë gati dokumentacionin, kemi bërë gati projektin se krahas gabinës e të tjera me radhë duan dhe projekt me elektrikun, për të bërë shtesë të fuqisë në atë zonë. Prapë sot ne folëm dhe do flasim që të jemi korrekt. Elizabeta- meqënëse jemi tek kthimi i përgjigjes për pyetjen time, doja të shtoja dhe diçka tjetër në lidhje me kangjellat e murit të shkollës Alush Grepcka. Kemi bërë kërkesë të përsëritur, disa herë e kemi thënë, atje duhet rrethimi emergjent i shkollës, thanë që do kalojë tek plani i emergjencave..Maksi- për murin mbajtës por jo për kangjellat..Elizabeta- po muri, ajo është e rrethuar me mur por muri është i ulët, do zgjasim murin apo do vëmë kangjellat? Maksi- ne me emergjencë kemi folur se ja kam dhe Drejtoreshën që ka bërë projektin e asaj pjesës atje, kemi folur për murin..Dr.Urbanistikës Eneida- po, por janë parashikuar të dyja, edhe kangjellat edhe muri..Elizabeta- do bëhet edhe mur edhe kangjella? Eneida- po,sepse një pjesë e murit ka çarje dhe

do bëhet forcim muri dhe sigurisht do shtojmë kangjella. Elizabeta- po prandaj po them, duhet të paktën Shtatorin e ardhshëm, gjatë këtyre dy muajve ajo të bëhet, në Shtator të jetë i mbyllur ky si problem kur të filloi shkolla. Kryetari- faleminderit Elizabeta. Problemi tjetër i ngritur në këtë Këshill është problemi i publikimit të fotove të qytetarëve, realizuar gjatë pritjeve të qytetarëve ditën e Enjte në Bashki, problem ky i ngritur nga z.Amarildo Hoxha. Në vijim të shqetësimit të paraqitur prej jush lidhur me publikimin në faqen zyrtare të Bashkisë fotografi nga takimet e përjavshme të ditës së Enjte me qytetarët, ju bëjmë me dije se Bashkia ushtron aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili detyron institucionet publike të garantojë transparencë me aktivitetet e tyre. Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i cili parashikon detyrimin për informimin dhe përfshirjen e qytetarëve në jetën publike, dhe ligjin 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar. Publikimi i materialeve fotografike nga aktivitetet e zyrave përbën një praktikë standarte dhe të ligjshme të institucioneve publike, në funksion të transparencës, informimin dhe llogaridhënies ndaj komunitetit. Në këtë kontekst sqarojmë se takimet e zhvilluara çdo të Enjte në ambientet e Bashkisë janë aktivitete zyrtare, me karakter publik në të cilat qytetarët paraqiten në mënyrë vullnetare. Bashkia nuk publikon të dhëna sensitive dhe nuk i përdorë materialet për qëllime të tjera, përveç se ato institucionale. 4.Është problemi në lidhje me pastrimin e mbeturinave, për arsye se punonjësit nuk pastrojnë koshat e mbeturinave, mbeturinat që janë rreth koshave..Në sallë ka diskutime. Kryetari- ju lutem sepse pengojmë, ju lutem sepse është në kuadër të transparencës dhe është e qartë ju lutem, z.Fredi ju lutem sepse jemi në fund. Problemi në lidhje me pastrimin e mbeturinave, për arsye se punonjësit kur pastrojnë koshat e mbeturinave, mbeturinat që janë rreth koshave nuk i pastrojnë siç duhet. Gjithandej gjendet mjedis i ndotur rreth koshave. Kthim përgjigje: Drejtoria e Menaxhimit të Territorit është duke marr masa për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të pastrimit dhe rritjes së kontrollit në territor. Problemi i gropave të krijuara anës rrugëve, të cilat janë bërë problematike tek ura qe lidh Sukun 1 poshtë, ku është shtëpia e z.Hajdar Karamani. Atje është një gropë shumë e madhe, kemi bërë shumë dëmtime kur kalojmë me makina dhe të gjithë shoferat ankohen për atë gropë. Të shikohet mundësia nga ana e Bashkisë për ta mbushur atë gropë. Kthim përgjigje: Problematika për gropën në rrugën që lidh Sukun 1, ju bëjmë me dije se është në inventarin e rrugëve të ARRSH-së, nga ana jonë është bërë verifikimi dhe është nisur informacion për çdo rrugë të dëmtuar në territorin e Bashkisë Roskovec. Dhurata- vetëm kaq, është e mjaftueshme? Kryetari- ky është kthimi i përgjigjes, thashë që ato do ti vlerësoni ju që keni bërë pyetjet, ndaj e zgjedha që ti lexojë. Në lidhje me ndriçimin në lagjen Agaçaj, është zonë e mbipopulluar dhe atje janë vendosur vetëm dy ndiçues. A do të vendoset dhe ndonjë ndiçues tjetër? Dhe kjo është nga znj.Dhurata. Kthim përgjigje: në lidhje me ndriçimin në lagjen Agaçaj, ne ofrojmë shërbimin e ndriçimit dhe në vazhdimësi të punës do të kryejmë përsëri përmirësimin e tij. Dhurata- se paguajmë taksat dhe është për të ardhur keq, është gjynah. Kryetari- këto ishin përgjigjet që kanë ardhur nga ana e administratës, kush është i interesuar që të ketë një kopje të këtyre përgjigjeve, mund ta tërheqi në përfundim të mbledhjes. Fjala është për z.Fredi. Fredi- në fshatin Ngjeqar familja e Dragot Vidhishtës të ndierit faktikisht, është miratuar këtu në Këshill si i pastrehë a rikonstruksionin e shtëpisë. Pavarsisht se ka kaluar afati ka 1 vit e gjysmë, familja sot për momentin është në qiell të hapur me plasmas. Nuk dua ti hyj teknikalitetit por fakti është ky që them unë, nuk e di se me hekur se pa hekur ça lidhje ka, është gjynah sot që bie shi, sot është me plasmas gjynah. Kush është arsyeja dhe pse, dhe si do veprohet? Maksi- do ketë një zgjidhje shumë të shpejtë..Fred- po sot e ka dhënë shi..Maksi- të Hënën në darkë është bërë heqja e çatisë për tu

bërë, tani dhe ajo do kohën e vet, ai projekti që është bërë me preventivin përkatës, ai që thoni ju jo me beton, jo pa beton..Fredri- me hekur..Maksi- me hekur, pa hekur e të gjitha me radhë, është përfshirë, jemi për ta mbyllur sa më shpejtë të jetë e mundur. Fredri- ore sa më shpejt të bëhet se po ti lëmë gjërat kështu, ajo është emergjencë..Maksi- të lutem edhe njëherë, jam marr jo vetëm të Hënën por edhe të Martën se sot është e Enjte, dhe të Mërkurën me familjarët dhe me persona të tjerë të fshatit, kemi qënë në vend 2-3 herë për ta mbyllur sa më shpejtë, është shqetësim i ligjshëm..Fredri- jo, na vjen turp.Maksi- edhe mua më vjen gjynah, e kam diskutuar këtë punë për të marr masat..Fredri- unë do kisha bërë video por më vjen..për shkelje privatësie nuk doja..Maksi- të thashë shqetësimi është i ligjshëm dhe faleminderit që e ngrite, por po merremi me atë. Dhurata-dhe një të fundit kisha unë, do ketë ndonjëherë ndonjë fond për këtë çunin, ti blejmë një kamer atij se ngeli me celular? Ja iu fik fare të shkretit, e la ngjysëm. Kryetari- kemi një kërkesë nga Leksi të përsëritur dhe të shfrytëzojmë faktin që kemi dhe Nënkryetarin këtu, që të vendosim datën e udhëtimit që do organizohet për Këshillin. Maksi- datën se caktojë unë, e cakton Këshilli, unë dua numrin. Kryetari- atëherë vendoseni bashkarisht, ju faleminderit.Mbyllet mbledhja.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

